

Matteo Cibic | Nancook of the North, 2015, Vanilla Noir collection | MDF, compensato e resina / MDF, kompensatés dhe reshiré



il nuovo | Ilaria Bianchi, Federica Biasi,
Matteo Cibic, Serena Confalonieri,
Antonio Facco, Elena Salmistraro, Tipstudio.

design italiano



**il nuovo
design italiano /
dizajni i ri italian**

08 luglio / korrik – 30 agosto / gusht 2021
COD - Center For Openness And Dialogue, Tirana.
Sala "Incontro con l'Artista" / Salla "Tako Artistin"

A cura di / Nën kujdesin e
Elisabetta Pisu

Una produzione / Një prodhim

IMF Foundation in collaborazione con EP studio

Traduzioni / Përkthimet

Albana Çuadari e Migena Kristo

Grafica / Grafika

Indrit Xhafaj



il
nu
ovo
des.
ignita
l'anno

08 luglio – 30 agosto 2021

/ korrik

/ gusht

dizaini
italian

Il design italiano ha lasciato un segno tangibile in Albania, dove è penetrato inizialmente grazie alla televisione ed è oggi comunemente apprezzato e diffuso. Per questo motivo sono particolarmente contento di presentare oggi questa piccola, ma significativa Mostra che porta per la prima volta in Albania i lavori di alcuni giovani e talentuosi interpreti del nuovo design italiano. Si tratta di autori accomunati dal dato anagrafico, ma che attingono a diverse fonti di ispirazione per le loro opere, dalle suggestioni mediterranee e mediorientali a quelle che discendono dall'estetica barocca o da un'ispirazione più marcatamente orientale. I loro lavori, pur nella grande originalità che li contraddistingue, costituiscono punto di snodo di una grande tradizione italiana che continua ad essere fonte di ispirazione e veicolo di diffusione di quel grande senso estetico che da sempre è associato con il nostro paese.

Dizajni italian ka lënë gjurmë të prekshme në Shqipëri, ku fillimisht depërtoi falë televizionit, ndërsa tani është vazhdimisht i vlerësuar dhe përhapur. Për këtë arsye jam veçanërisht i lumtur të prezantoj sot këtë Ekspozitë të vogël, por domethënëse, e cila sjell për herë të parë në Shqipëri punimet e disa interpretuesve të rinj dhe të talentuar të dizajnit të ri Italian. Kemi të bëjmë me autorë që i bashkojnë të dhënat personale, por që nga ana tjetër për punët e tyre frymëzohen nga burime të ndryshme, nga ndikimet mesdhetare dhe jugore deri tek ato që rrjedhin nga estetika baroke apo nga një frymëzim më i spikatur lindor. Veprat e tyre, megjithë origjinalitetin e madh që i dallon, përbëjnë qendrën e një tradite të rëndësishme italiane, e cila vazhdon të jetë burim frymëzimi dhe një mjet për përhapjen e asaj ndjenje të thellë estetike që gjithmonë ka shoqëruar vendin tonë.

Fabrizio BUCCI
Ambasciatore d'Italia

design /di'zain/, it. /di'zain/ s. ingl. [propr. "disegno, progetto", dal fr. dessein, a sua volta dall'ital. disegno], usato in ital. al masch. - **1.** (*industr.*) [progettazione di oggetti d'uso comune mirante a conciliare funzionalità, estetica ed economicità] ≈ *industrial design*. **2.** (*estens.*) [la forma stessa assunta da tali oggetti: *il d. italiano è famoso nel mondo*] ≈ Il linea, stile.

È sempre più difficile definire i confini del design. Ambiti nuovi e molto diversi si sono appropriati del termine: oggi si parla di *interactive design*, *graphic design*, *web design*, *visual design*, *food design* e l'elenco potrebbe continuare. La definizione offerta dalla Treccani ci riporta in qualche modo non solo all'inizio della storia gloriosa – di oltre un secolo - dei prodotti italiani, ma ci ricorda anche la sua essenza e peculiarità: il design italiano nasce movimentista, sperimentale e all'avanguardia, straordinario nella sua semplicità, ma anche accessibile e sobrio. Caratteristiche che rendono i suoi prodotti istantaneamente riconoscibili e senza tempo.

I nuovi designer italiani esposti a Tirana nella *Sala 'Incontro con l'Artista'* del COD – mai spazio migliore avrebbe potuto accoglierli – pur nella loro contemporaneità e originalità testimoniano di quella continuità che rende il design italiano famoso nel mondo.

design / di'zain /, italisht / di'zain / anglisht ["dizajn, projekt", nga frëngjishtja dessein, po në italisht disegno], përdorur në gjininë mashkullore - **1.** (*industr.*) [projektim i objekteve të përdorimit të përditshëm, që synon pajtimin e funksionalitetit, estetikës dhe ekonomisë] ≈ *industrial design*. **2.** (*zgjatim*) [vetë forma e marrë nga objekte të tilla: dizajni italian është i famshëm në botë] ≈ Il linjë, stil.

Është gjithmonë e më e vështirë të përcaktohen kufijtë e dizajnit. Kuptime të reja dhe shumë të ndryshme e kanë përvetësuar termin: sot flasim për dizajnin interaktiv, dizajnin grafik, dizajnin web, dizajnin vizual, *food design* dhe kështu lista vazhdon. Përkufizimi i dhënë nga Treccani na kthen në një farë mënyre jo vetëm në fillimet e historisë së lavdishme - të mbi një shekulli - të produkteve italiane, por gjithashtu na kujton thelbin dhe veçoritë e tij: dizajni italian lind nga lëvizja *movimentista*, eksperimental dhe avangardë, i jashtëzakonshëm në thjeshtësinë e tij, por edhe i arritshëm dhe i matur. Këto karakteristika i bëjnë produktet e tij të njihen menjëherë dhe të mbeten të përjetshme.

Dizenjuesit e rinj italianë të cilët po ekspozojnë në Tiranë në Sallën "Tako Artistin" në COD – asnjë hapësirë më e mirë do të kishte mundur t'i mirëpriste - edhe pse në bashkëkohësinë dhe origjinalitetin e tyre, dëshmojnë vazhdimësinë që e bën dizajnin italian të famshëm në të gjithë botën.

Alessandra BERTINI MALGARINI

Istituto Italiano di Cultura di Tirana - Direttore

Il design italiano, sin dal dopoguerra, ha vissuto un dualismo endemico, costantemente diviso tra artigianato e industria, tra standardizzazione e genialità individuale, passando da una corrente di pensiero ad un'altra. Dal razionalismo del *Good Design*, che esalta il rapporto tra forma e funzione privilegiando le geometrie elementari, si è passati al design "integrale" di Achille e Pier Giacomo Castiglioni, capace di incorporare nel progetto forma, materia e tecnica, alla svolta 'organica' di Marco Zanuso che anticipa lo stile *high-tech*. Fino al *Radical design*, definito anche contro-design, "contestazione del presente" dove l'ironia diventa elemento prevalente. Per approdare, poi, al *Neomodern*, un'immagine di rinnovamento, un design dal linguaggio simbolico e dalla cinica allegria. Oggi una generazione di talenti raffinati, curiosi, senza dogmi, in grado di fare i conti con la tradizione e i "grandi maestri" del passato, sta dando vita a una nuova stagione del progetto italiano, con creazioni dal forte impatto evocativo che sconfinano nell'arte. Dettagli, materiali, forme, libertà creativa e un approccio emozionale si affacciano sulla contemporaneità: si abbandona l'idea di un design standardizzato e si punta sull'unicità dell'oggetto. Ecco quindi la semplicità formale e l'estetica minimalista di Federica Biasi; il design utopico di Matteo Cibic tra design, arte e alto artigianato; l'umanesimo di Antonio Facco che spazia dall'architettura d'interni all'oggetto; l'armonia delle forme e lo stile poetico di Elena Salmistraro, commistione tra illustrazione, design e arti visive; la sperimentazione e la profonda analisi sulla materia del duo creativo Tipstudio, che trasforma ogni idea in un prodotto narrativo e simbolico; le forme archetipiche e il linguaggio espressivo di Ilaria Bianchi verso un design di stampo più critico e concettuale; le superfici grafiche di Serena Confalonieri che nel contrasto tra forma e colore, esaltano la leggerezza degli oggetti. Passione, tradizione, innovazione e soprattutto un elogio della lentezza, dell'*handmade*, della qualità rispetto alla quantità, così si delinea il nuovo "Made in Italy", quale indispensabile risorsa dell'economia italiana.

Elisabetta Pisu

IMF Foundation, Roma

Dizajni italian, që nga periudha e pasluftës, ka përjetuar një dualizëm endemik, të ndarë vazhdimisht mes punimeve artizanale dhe industrisë, mes standardizimit dhe gjenialitetit individual, duke kaluar nga një rrymë mendimi tek tjetra. Nga racionalizmi i *Good Design*, i cili nxjerr në pah marrëdhënien midis formës dhe funksionit, duke favorizuar gjeometritë elementare, është kaluar tek dizajni "integral" i Achille dhe Pier Giacomo Castiglioni, i aftë të përfshijë në projekt formën, materialin dhe teknikën, tek pika e kthesës "organike" të Marco Zanuso, i cili pararend stilin *high-tech*, e deri tek *Radical design*, i quajtur ndryshe edhe contro-design, "kontestim i së tashmes" ku ironia bëhet elementi mbizotërues. Për të arritur më pas tek *Neomodern*, një imazh rinovimi, një dizajn me gjuhë simbolike dhe gëzim cinik. Sot një brez talentesh me shije të hollë, kuriozë, pa dogma, të aftë për t'u marrë me traditën dhe "mjeshttrat e mëdhenj" të së kaluarës, po i japin jetë një sezoni të ri të dizajnit italian, me krijime me një ndikim të fortë ndjellës që puqen me artin. Detajet, materialet, format, liria krijuese dhe çasja emocionale ballafaqohen me të tashmen: braktiset kështu ideja e një modeli të standardizuar dhe fokusi përqëndrohet tek origjinaliteti i objektit. Prej këtu thjeshtësia e formës dhe estetika minimaliste e Federica Biasi; dizajni utopik i Matteo Cibic mes dizajnit, artit dhe mjeshtërisë së lartë artizanale; humanizmi i Antonio Facco që shkon nga arkitektura e brendshme tek objekti; harmonia e formave dhe stili poetik i Elena Salmistraro, një përzierje e ilustrimit, dizajnit dhe arteve pamore; eksperimentimi dhe analiza e thelluar mbi materjen e dyshe krijuese Tipstudio, që shndërron çdo ide në një produkt narrativ dhe simbolik; format arketipike dhe gjuha shprehëse e Ilaria Bianchi, drejt një dizajni stampimi më kritik dhe konceptual; sipërfaqet grafike të Serena Confalonieri, të cilat në kontrast midis formës dhe ngjyrës, bëjnë të spikasë lehtësia e objekteve. Pasion, traditë, inovacion dhe mbi të gjitha lavd ngadalësisë, punimit *handmade*, cilësisë mbi sasinë, kështu përvijohet "Made in Italy" i ri, si një burim i domosdoshëm i ekonomisë italiane.



Essenziale, 2018

*Collezione di tre diffusori per essenze / Koleksion i tre difuzorëve për esencat:
Circus, Wheel, Carousel.*

Marmo e ottone / Mermer dhe tunxh

Foto: Tommaso Tanini

Ilaria Bianchi

Formatasi al Politecnico di Torino e alla Central Saint Martins di Londra, Ilaria Bianchi (Pisa, 1989) apre il suo studio a Milano nel 2015. La sua attività progettuale, sempre incentrata su un tratto rigoroso e una spiccata ricerca concettuale, spazia tra arredi e allestimenti ed include anche l'attività didattica e giornalistica. Le sue opere sono state esposte, tra gli altri, al Victoria & Albert Museum, alla Triennale di Milano e da Chamber NYC. La collezione *Essenziale*, sviluppata per Wallpaper* Handmade, esplora in maniera originale l'interesse crescente per i diffusori di profumo domestici. Sviluppata come oggetti cinetici in marmo e prodotti dall'azienda veronese Il Marmo i diffusori ruotano nell'ambiente impregnandolo di una fragranza realizzata dal marchio Ostens con la profumiera Juliette Karagueuzogiu.

E diplomuar në Politecnico di Torino dhe Central Saint Martins në Londër, Ilaria Bianchi (Pisa, 1989) hapi studion e saj në Milano në vitin 2015. Aktiviteti i saj projektues, gjithmonë i përqëndruar mbi tipare rigorozë dhe një hulumtim i fortë konceptual, shkon nga mobilimi tek pajimet dhe përfshin gjithashtu veprimtari didaktike dhe gazetareske. Punimet e saj janë ekspozuar, ndër të tjera, në Muzeun Victoria & Albert, Trienalen e Milanos dhe Dhomën NYC. Koleksioni *Essenziale*, i zhvilluar për Wallpaper* Handmade, eksploron interesin në rritje për aromatizuesit e shtëpisë, në një mënyrë krejt origjinale. Të konceptuar si objekte kinetike në mermer dhe të prodhuar nga kompania veroneze Il Marmo, ata rrotullohen në dhomë, duke e mbarsur atë me një aromë të krijuar nga marka Ostens me parfumieren Juliette Karagueuzogiu.



Elettra, 2017


Mingardo

Rame e ferro / Bakër dhe hekur

Federica Biasi (1989) si laurea all'Istituto Europeo di Design di Milano e lavora come designer e consulente in Italia e in Olanda prima di aprire il suo studio nel 2015 a Milano. La sua predilezione per forme essenziali ma mai severe si declina su un ampio spettro di creazioni, tra cui sedute (per Gallotti Radice, Manerba), oggetti per la tavola (Fratelli Guzzini, Nespresso), e tappeti e rivestimenti (Cc-tapis), nei quali combina attenzione ai dettagli materici e sensibilità per il colore. Con il vaso *Elettra*, realizzato per il marchio Mingardo di cui è anche direttore artistico, concepisce un oggetto poetico che permette di mettere in risalto il fiore attraverso la sospensione del suo cilindro contenitore dalla superficie di appoggio.

Federica Biasi (1989), e diplomuar në Institutin Evropian të Dizajnit në Milano, punoi si specialiste dizajni dhe konsulente në Itali dhe Hollandë përpara se të hapte studion e saj në vitin 2015 në Milano. Prirja e saj për forma thelbësore, por asnjëherë të ngurta, shprehet në një gamë të gjerë krijimesh, përfshirë karrige (për Gallotti Radice, Manerba), objekte të ndryshme për tavolinë (Fratelli Guzzini, Nespresso) si dhe qilima e tapiceri (Cc-tapis), në të cilat kombinon vëmendjen për detajet e materialit me ndjeshmërinë ndaj ngjyrës. Me vazon *Elettra*, krijuar për markën Mingardo, ku është gjithashtu drejtore artistike, ajo ka konceptuar një objekt poetik që lejon lulen të dalë në pah, përmes shkëputjes nga sipërfaqja mbështetëse e vazos ku është vendosur.

Federica Biasi



Wings, 2015

Vanilla Noir Collection / Koleksioni Noir Vanilla

Scarlet Splendour

MDF, resina e vetro / MDF, rrëshirë dhe qelq

Enfant terrible della nuova scena del design italiano, Matteo Cibic (Parma, 1983) ha dato corpo ad interni, arredi ed oggetti che sposano attitudine decorativa e continue sollecitazioni fantastiche. La sua visionarietà, spesso legata a forme antropomorfe o animali, esalta la preziosità riconducendola ad un tratto epurato e contemporaneo. Tra i primi designer internazionali a collaborare con un marchio indiano, Cibic realizza per Scarlet Splendour un inedito cavallo a dondolo, *Nanook of the North*, che riprende la vecchia tecnica locale dell'intarsio in avorio reinterpretandolo in chiave sostenibile grazie all'utilizzo della resina. Nello specchio *Wings*, sempre per Scarlet Splendour, il netto contrasto grafico del bianco e nero viene esaltato dal ricco disegno del profilo della cornice.

Enfant terrible i skenës së re të dizajnit italian, Matteo Cibic (Parma, 1983), u ka dhënë formë orendive, mobiljeve dhe objekteve duke i veshur me dekoracione dhe stimuj fantastikor të vazhdueshëm. Natyra e tij vizionare, shpesh e lidhur me forma antropomorfe apo shtazore, rrit vlerat, duke u kthyer në një tipar të pastër dhe bashkëkohor. Një nga dizajnerët e parë ndërkombëtarë që bashkëpunoi me një markë indiane, Cibic krijoi për Scarlet Splendour, një kalë origjinal lëkundës, *Nanook of the North*, i cili bazohet tek teknika e vjetër lokale e gdhendjes në fildish, duke e riinterpretuar atë në mënyrë logjike, falë përdorimit të rrëshirës. Në pasqyrën *Wings*, gjithmonë për Scarlet Splendor, kontrasti i mprehtë grafik i të zezës dhe të bardhës, spikat edhe më shumë falë dizajnit të pasur të profilit të kornizës.

Matteo Cibic



Arabesque collezione, 2019

Vetro borosilicato / Qelq borosilikat

foto: Andrea Agrati

Serena Confalonieri

Serena Confalonieri (Vimercate, Monza e Brianza, 1980) è una designer e art director con base a Milano attiva nel campo del product, interior, graphic e textile design. La sua cifra stilistica fortemente identitaria è costruita intorno ad una visione grafica, colorata ed emozionale, con iperboli decorative e forme geometriche. Nel corso degli anni, ha collaborato con importanti aziende (cc-tapis, Saba Italia, Sambonet, Wall&decò) e rinomate istituzioni (Triennale Milano, Fondazione Cologni, Michelangelo Foundation). Ha preso parte a progetti con l'obiettivo di guidare piccole realtà artigianali verso forme e prodotti più contemporanei. I vasi della collezione *Arabesque* aggiornano l'eredità post-moderna, esaltando in chiave iperbolica il contrasto tra forme e colori attraverso un equilibrio ponderato tra massimalismo e leggerezza.

Serena Confalonieri (Vimercate, Monza dhe Brianza, 1980) është specialiste dizajni dhe drejtore arti, e vendosur në Milano, aktive në fushën e dizajnit produktiv, interier, grafik dhe atij tekstil. Kodi i saj stilistik me identitet të fortë, ndërtohet rreth një vizioni grafik shumëngjyrësh dhe emocional, me hiperbola dekorative dhe forma gjeometrike. Ndër vite, ka bashkëpunuar me kompani të rëndësishme (cc-tapis, Saba Italia, Sambonet, Wall & decò) dhe institucione të njohura (Triennale Milano, Fondazione Cologni, Michelangelo Foundation). Ka marrë pjesë në projekte që kanë patur synim drejtimin e bizneseve të vogla artisanale drejt formave dhe produkteve më bashkëkohore. Vazot nga koleksioni *Arabesque* përditësojnë trashëgiminë post-moderne, duke nxjerrë në pah kontrastin midis formave dhe ngjyrave në mënyrë hiperbolike, përmes një ekuilibri të mirë menduar mes maksimalizmit dhe lehtësisë.



Mondo, 2017

Oblure

Acciaio e vetro / Çelik dhe qelq

L'attività progettuale di Antonio Facco (Milano, 1991) abbraccia senza soluzione di continuità l'architettura d'interni, l'allestimento, l'arredo e l'oggetto, distillando forme iconiche sempre mosse da una attenta ricerca del contesto d'uso e dell'orizzonte culturale di riferimento. La lampada da terra *Mondo*, progettata per il marchio Oblure, rievoca il funzionamento di un mappamondo che viene schermato da due griglie metalliche dal pattern differente: all'utente è lasciata la possibilità di far scorrere a piacimento le griglie, modulando l'intensità della luce come si trattasse di un'eclisse e giocando con gli effetti grafici dati dalla sovrapposizione tra linee ortogonali.

Aktiviteti projektues i Antonio Facco (Milano, 1991) përqafon pa ndërprejre arkitekturën e brendshme, pajimet, mobilimin dhe objektin, duke përfutur forma ikonike gjithmonë në lëvizje, për shkak të një hulumtimi të kujdesshëm të kontekstit të përdorimit dhe horizontit kulturor të cilit i referohen. Llamba e dyshemesë *Mondo*, e projektuar për markën Oblure, evokon funksionimin e një globi tokësor që mbrohet nga dy rrjeta metalike me modele të ndryshme: përdoruesit i lihet mundësia të rrëshqasë rrjetat sipas dëshirës, duke modifikuar intensitetin e dritës sikur të ishte eklips, si dhe të luajë me efektet grafike, të krijuara falë mbivendosjes së linjave ortogonale.

Antonio Facco



MRND, 2015

Seletti

Porcellana, vetro, plastica e legno / Porcelan, qelq, plastikë dhe dru.

Elena Salmistraro

Tra le giovani leve del nuovo design italiano, Elena Salmistraro (Milano, 1983) è quella che maggiormente ha fatto proprio il linguaggio della figurazione e del disegno. Laureata in Industrial Design al Politecnico di Milano, apre il suo studio con Angelo Stoli nel 2009 e inizia a collaborare con grandi marchi dell'arredo e del complemento oggetto (tra i quali Alessi e Bosa) e allo stesso tempo a esporre presso gallerie ed esposizioni collettive (The New Italian Design, W. Women in Italian Design). Realizzata per il marchio Seletti, la sua serie di vasi *MRND* – un tributo a Giorgio Morandi – restituisce l'atmosfera e la delicata matericità delle nature morte del grande artista bolognese attraverso un equilibrio ponderato tra composizione geometrica, combinazioni cromatiche e texture.

Midis brezit të ri të dizajnit të sotshëm italian, Elena Salmistraro (Milano, 1983) është ajo që më së shumti ka përvetësuar gjuhën e figuracionit dhe dizajnit. E diplomuar në Industrial Design në Politecnico di Milano, hapi studion e saj së bashku me Angelo Stoli në vitin 2009, dhe nisi bashkëpunimin me marka të rëndësishme mobiljesh dhe orendish të tjera (përfshirë Alessi dhe Bosa), duke ekspozuar në të njëjtën kohë në galeri apo ekspozita kolektive të ndryshme (The New Italian Design, W. Women in Italian Design). E realizuar për markën Seletti, seria e saj e vazove *MRND* - për nder të artistit Giorgio Morandi – rikrijon atmosferën dhe materialitetin delikat të natyrës së qetë të artistit të madh bolonjz, përmes një ekuilibri të mirë peshuar mes përbërjes gjeometrike dhe kombinimit të ngjyrave e strukturave.



Apollineo, 2019

Collezione Mediterranea / Koleksion Mesdhetar: Arco-Specchiera; Colonna-Vaso; Arena-Fruttiera; Scaletta-Portacandela; Contrafforti-Fermalibri / Harku-Pasqyrë; Kolona-vazo; Arena-tas me fruta; Shkalla-mbajtëse qiriri; Harkatat - Libërmbajtëse. Pietra leccese e maioliche decorate a mano / Gur leçez dhe majolika të zbukuruar me dorë.

Fondato a Firenze dall'incontro tra una designer di prodotto, Imma Matera, e un maker, Tommaso Lucarini, Tipstudio sperimenta combinazioni formali e materiche che si traducono in oggetti caratterizzati da una forte sollecitazione tattile e sensoriale. L'indagine sul territorio è spesso il punto di partenza dei loro progetti, che rileggono storie ed antiche tradizioni artigianali attraverso le sensibilità e le domande del presente. Per la collezione *Apollineo*, vincitrice del Materia Design Festival nel 2019, l'uso della pietra leccese, della calcarenite e delle maioliche viene restituito attraverso forme essenziali che replicano gli effetti di un materiale corrosivo dall'azione del tempo. Scaletta e contrafforti, rispettivamente un portacandele e un fermalibri, mimano tipologie architettoniche ed oggetti idealtipici e giocano sull'ironia scaturita dalle loro ridotte dimensioni.

Krijuar në Firenze nga takimi mes një specialiste dizajni produkti, Imma Matera dhe një krijuesi, Tommaso Lucarini, Tipstudio eksperimenton kombinime formash dhe materialesh, të cilat përkthehen në objekte të karakterizuara nga një stimul i fortë ndjesor. Kqyrja e territorit shpesh është pika fillestare e projekteve të tyre, të cilat i referohen historive dhe traditave të lashta artisanale, përmes ndjeshmërisë dhe pyetjeve të së tashmes. Për koleksionin *Apollineo*, fitues i Festivalit Materia Design, në vitin 2019, përdorimi i gurit të krahinës së Lecce-s, të gurit gëlqeror dhe majolikës, rikthehet përmes formave thelbësore, të cilat shumëfishojnë efektet e një materiali të gërryer nga veprimi i kohës. Shkallët dhe mbështetëset, përkatësisht një mbajtëse qirinsh dhe një mbajtëse libri, imitojnë tipologji arkitektonike dhe objekte tipike ideale, duke luajtur me ironinë, që buron nga përmasat e tyre të vockla.

Tipstudio

